

D E K R E T
Nr.1291, datë 20.11.1995

**“PËR FALJEN E PIANOVE KOMPOZITORËVE, KRITIKËVE, STUDIUESVE DHE
INTERPRETUESVE TË MUZIKËS”**

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,

D E K R E T O J:

Neni 1

Të falen pianot e dhëna nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë në përdorim, me kontrata të rregullta, kompozitorëve, kritikëve, studiuesve dhe interpretuesve të muzikës, anëtarë të saj. Në këtë kontingjent përfshihen edhe pianot e dhëna në përdorim me kontrata të rregullta kompozitorëve, kritikëve, studiuesve dhe interpretuesve, anëtarë të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë nga Akademia e Arteve dhe Qendra e Veprimtarive Folklorike.

Neni 2

Për zbatimin e këtij dekreti ngarkohen Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Arsimit për të nxjerrë udhëzimet përkatëse në bashkëpunim me Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

KUNDËRFIRMOHET
MINISTRI I KULTURËS, RINISË
DHE SPORTEVE
Teodor Laço

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha